



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:014960

Datë: 21.03.2022

Numri i dokumentit: 02818118

P.nr. 45/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi-Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit Gj.(K.)K nga fsh. N, Komuna e P., i akuzuar për veprën penale dhunë në familje nga neni 248, par.1, te KPRK-së, sipas aktakuzës së PP/II.nr.65/2022, të dt. 20.01.2022, pas mbajtjes së seancës jo-publike të shqyrtimit fillestar të datës, 16.03.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit A. G, të pandehurit Gj. (K.) K, të dëmtuarës V. K, mbrojtësit të viktimave D. H në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.21.03.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Gj. (K.) K, i lindur me në Pejë, tani me banim në fsh.... K- P., nga babai K. e nëna Z. e gjinisë B. ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, gjendje së mesme ekonomike, i identifikuar, në bazë të letërnjoftimit me nr....., posedon telefon me nr.i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Në vazhdimësi e gjer me dt. 07.01.2022, ne fsh N. K-P. pikërisht në shtëpinë e tij, ushtron dhunë psikike ndaj bashkëshortes se tij-te dëmtuarës V. K, ne atë mënyrë qe ditën kritike pas një mosmarrëveshje qe kishin pasur ne mes veti (*për shkak të xhelozisë sepse dyshon se e dëmtuara ka lidhje me persona tjerë*), i njëjti ia kishte thyer telefonin dhe e gjuan me gjësende te ndryshme te shtëpisë, gjithashtu e detyron te dëmtuarën te largohet nga shtëpia,

-me çka ka kryer veprë penale dhunë në familje nga neni 248 par.1, te KPRK-së,

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40,42, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 248 par.1 te KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit Gj. (K.) K, i përcaktohet:

- I. **Dënimi me burgim** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej **1 (një) viti**, nuk do të kryej veprë tjetër penale, dhe
- II. **Dënim me gjobë** në shumë prej 400 (katërqindë) euro, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk do të kryej veprë tjetër penale.

I pandehuri obligohet në pagimin e shpenzimeve për paushallin gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.65/22, të dt. 20.01.2022, kundër të pandehuri Gj. (K.) K, nga fsh. N. komuna e P. i akuzuar për veprën penale dhunë në familje nga neni 248, par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 16.03.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ku ish-in prezent prokurori i shtetit A. G, i pandehuri Gj. K, mbrojtësi i viktimave D. H dhe e dëmtuara V. K.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta, dhe shtoi se nuk ka nevojë për mbrojtës.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, ka shprehur pendimin dhe keqardhjen për veprën e kryer, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe i ka kërkuar falje palës së dëmtuar para gjykatës.

Prokurori e shtetit ka deklaruar: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit shihet që është i vullnetshëm dhe ka përpunje në shkresat e lëndës. Gjykatës i ka propozuar që ta pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit dhe të merr si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin dhe keqardhjen, ndërsa rrethanat rënduese nëse ka ja ka lënë gjykatës në vlerësim.

Mbrojtësi i viktimave ka deklaruar : Pajtohet ne tërësi me fjalën e prokurorit të shtetit, gjithashtu pranë kësaj gjykatë ka dorëzuar edhe deklaratën e pëlqimit për ndihmë të viktimave të cilën pala e mbrojtur e ka dhënë pranë ZMNV-së me dt.25.01.2022 e cila deklaron së marrëdhëniet bashkëshortore janë përmirësuar dhe në mënyrë vullnetare heq dorë nga kërkesa për urdhër mbrojtje me çka vërtetohet së marrëdhëniet bashkëshortore janë përmirësuar, gjithashtu ka deklaruar së nuk ka kërkuar kompensim dëmi.

E dëmtuara ka deklaruar : pajtohet me pranimin e fajësisë së të pandehurit, raportet tona janë përmirësuar, sa i përket procedurës civile e kam tërhequr kërkesën për urdhër mbrojtje pasi që ne jemi pajtuar. Sa i përket kompensimit të dëmit nuk kërkoj një gjë të tillë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti zyrtar, i përpiluar nga zyrtari policor Q. Sh, i dt. 07.01.2022, raporti i policit B. L, i dt. 07.01.2022, raporti i policit hetues F. I, i dt. 07.01.2022, deklarata e të dëmtuarës V. K e dt. 07.01.2022, deklarata e të pandehurit Gj. K, e dhënë pranë stacionit policor ne Pejë, me dt. 07.01.2022, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Gj. K, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të dhunës në familje nga neni 248, par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, pranimin e fajësisë, pendimin dhe keqardhjen për veprën e kryer dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar dhe nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij, përmirësimin e raporteve me palën e dëmtuar si dhe kërkim faljen ndaj palës së dëmtuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës në shumën prej 30 € (tridhjetë euro), si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.45/22, dt. 21.03.2022**

Bashkëpunëtore profesionale
Kaltrina Rexhepi-Imami

GJYQTARI
Veton Ademaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.